

# FOREVER



HUNGARY / ALBANIA / BOSNIA AND HERZEGOVINA / CROATIA / MONTENEGRO / SERBIA / SLOVENIA



THE EXECUTIVE COMMITTEE  
CONGRATULATES

**FLP HUNGARY**

*Albania, Bosnia & Herzegovina, Croatia,  
Kosovo, Serbia, Montenegro & Slovenia*

FOR ACHIEVING THE HIGHEST  
OPERATIONAL AND FINANCIAL  
MANAGEMENT RATING OF

**EXCELLENT**

THANK YOU FOR YOUR HARD  
WORK AND DEDICATION  
2009

*Dee Maughon*  
CHAIRMAN & CEO

FOREVER LIVING PRODUCTS



3<sup>RD</sup>

IN WORLDWIDE SALES  
2008-2009

*Congratulations  
And Thank You To All The  
Great Distributors Of*

HUNGARY, ALBANIA, BOSNIA & HERZEGOVINA,  
CROATIA, KOSOVO, SERBIA, MONTENEGRO & SLOVENIA

*Dee Maughon*  
CHAIRMAN & CEO

FOREVER LIVING PRODUCTS

**N**donjëherë kur ulem të shkruaj këtë përshëndetje më duhen disa minuta derisa të gjej temën e duhur. Në këtë muaj dëshiroj të ndaj me ju aq shumë gjëra, sa po vras mendjen që çfarë të lë pa përmendur. Në javët e kaluara gjithë zyra digjej nga zjarri i Super Rallyt. Kjo është ngjarja më e madhe e vitit, dhe pavarësisht se gjatë viteve të kaluara u zhvilluam shumë, me detajet merremi akoma vetë. Jam i sigurt që ka rrugëzgjidhje tjetër, që ekziston diku një këshilltar i cili mund të na thojë se si t'i ndajmë detyrat, si të përfaqësohemi dhe si ta shmangim vetveten nga detajet. Po të zgjedhim këtë metodë nuk do i njihim emrat tuaj, llojin e dhomave ku strehoheni, me çfarë avioni udhëtoni apo nivelin që keni arritur, sepse në këtë rast këto parametra do t'ua jepni dikujt tjetër.

Mesazhi im i sotëm për ju është theksimi i rëndësisë së ruajtjes së detajeve të përditshme në interes të një muaji, çerekviti, viti apo periudhe më të gjatë të suksesshme. Kam venë re distributorët drejtues të kompanisë sonë të cilët çdo ditë "ndodhen në terren", flasin me njerëzit, u bëjnë të njohur produktet tona, nxjerrin publikime dhe mbajnë leksione. Ndodhen në kontakt të përditshëm me rrjetin e tyre nëpërmjet Facebook dhe Twitter, apo me ndihmën e My FLP Biz (së shpejti do të arrijë edhe në Hungari) biznesi ynë forcohet. Zotërojnë biznese aktive dhe rriten vazhdimisht. Ndryshe nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje detajeve dhe biznesi i të cilëve dobësohet dalëngadalë.

Javën e kaluar ishte një Rally i shkëlqyer! Prezantuam disa produkte të reja të mrekullueshme, festuam

kualifikimet dhe e ndjemë mirë veten! Falenderojmë të gjithë ata që u kualifikuan dhe punuan shumë për 12 muaj me radhë; ju presim edhe vitin e ardhshëm, mund ta bëni përsëri. Dhe ata të cilët nuk arritën të kualifikohen sivjet, i nxis që t'ia venë vetes përsëri si pikësynim Super Rallyn, të motivojnë linjat e poshtme të cilët gjithashtu duhet t'i venë vetes piksynime... dhe bëjeni realitet!

Disa vite më parë udhëtonim shpesh në veri, nga Arizona në Utah. Gjatë këtyre udhëtimeve e shfrytëzojmë gjithmonë rastin dhe qëndronim tek vendi i mrekullueshëm Bryce Canyon, dhe shijonim bukurinë që të linte me gojë hapur dhe natyrën magjepse. E kisha gjithmonë një nga pikësynimet e mia që të shijoja mbresën e ofruar nga Bryce Canyon dhe që kjo bukuri të shikohet edhe nga miliona njerëz të tjerë. Prandaj tani i emocionuar po ju njoftoj se Forever Resorts tani afër lidhi kontratë për drejtimin e këtij vendi pushimi me nivel botëror. Ashtu si Forever Living, edhe Forever Resorts rritet, dhe jemi shumë krenar për kontratën e re.

Po filloj të dalloj se sa me fat jemi dhe çfarë suksesesh kemi arritur. Nëse tani dikush do të pyeste shkaku që "përse", do mund t'i përgjigjesha vetëm me një thënie të njohur të Cadet Maxim:

*"Rreziko më shumë se sa ajo që të tjerët e mendojnë të sigurt;  
Bëj më shumë se sa ajo që të tjerët e mendojnë të mençur;  
Ëndërro më shumë se sa ajo që të tjerët e mendojnë reale;  
Prit më shumë se sa ajo që të tjerët e mendojnë të mundshme."*





*Dr. Sandor Milesz*

# *Ria, Ria, Hungaria!* *Ria, Ria, Serbia!*

## **MORRËM MEDALJE BRONZI!**

**M**ë vjen mirë ta shkruaj këtë fjali. Shumë ditë pune të lodhshme, momente plot gëzim, këmbëngulja e pafund e qindra mijëra njerëzve. Angazhimi i një skuadre drejtuesish. Dhe bashkë me ta një numër i pafund distributorësh të shkëlqyer. Qindra mijëra të njohur dhe miq të rinj, mendime të njëjta, refuzime, të cilat mund t'i përmbledhim në një fjali të vetme. E meritojmë vendin III në botë.

Në këtë shoqëri që në shumë raste ka humbur dhe s'i gjykon vlerat, është shumë e rëndësishme që ekzistojmë, punojmë dhe arrijmë rezultate të mëdha. U bëjmë të njohur emrin e Forever-it punonjësve të rinj në vend dhe jashtë tij. Dhe jo një emër dosido, por emrin e mirë të Forever-it. Pas 12 vitesh deklaroj me zemër të qetë se jam i bindur që ajo që bëjmë, për të cilën punojmë, e bëjmë për veten, familjen, miqtë, vëllezërit dhe

të afërmit tanë. Në mënyrë që edhe ata të jetojnë në rrethanat e mira, një jetë të gjatë e të shëndetshme, të cilën na e jep presidenti ynë Rex Maughan. Dhe ne, qindra mijëra vetë punojmë me këmbëngulje dhe ndershmëri që këtë mentalitet t'ua përcjellim gjithë miqve tanë.

Të gëzohemi sepse kemi punuar shumë për gjithçka që kemi arritur. Është një rezultat madhështor në këtë garë të madhe të jesh i treti me 143 vendesh në botë. Kemi punuar shumë për këtë ne hungarezët, serbët, kroatët, boshnjakët, malazezët, kosovarët, shqiptarët dhe slovenët në unitet për një qëllim të përbashkët në një nga aktivitetet më të mëdha të botës, në Super Rallyn e Dallasit.

Ju që përfaqësoni këtë rajon, ata dyqind vetë në Dallas, Ju skuadra më entuziaste e botës, Ju u dëgjuat më

shumë nga të tërë. Me ju filloi çdo ditë dhe u mbyll Super Rally.

Isha i gëzuar dhe krenar që festova me ju në skenë. Është një mbresë e madhe të gëzosh së bashku për sukseset dhe vlerësimet e të tjerëve.

Në zemër, në shpirt dhe në mendje ne jemi më të mirët. Mungon shumë pak, secili duhet të lëviz pak nga zona e rehatit dhe të bëjë gjithçka që në vitin 2010 në Denver të dëgjohet kudo: Ria ria Hungaria, Ria ria Serbia dhe ndoshta Kroacia, Bosnja dhe Sllovenia.

Ne ishim, jemi dhe do të jemi më të mirët!

Përpara FLP Hungari!

**DR. SANDOR MILESZ**  
*drejtor gjeneral*



# Në përgatitje për sundimin e Londrës

Në këtë mëngjes të nxehtë njerëzit u tërhoqën edhe nga ajri i kondicionuar i Arenës Sportive Papp Laszlo. Po nga Dita e Suksesit të organizuar në kuadrin e Rallyt European të Londrës?

**P**as himnit të Forever-it si hyrje mijëra mysafirët u argëtuan nga shfaqja ritmike me valle popullore e Teatrit të Valles Popullore të Ushtrisë (**Gergely Gyurka** dhe **David Kiss Gergely**) bashkë me shfaqjen mysafirët nga Amsterdam **Attila Bedő**. Drejtuesit e programit, soa ring manexherët **Dr. Terezia Samu** dhe **Andras Bruckner**

përhëndetën pjesëmarrësit të cilët ndërkohë i kishin zënë vendet e tyre.

Të gjithë po prisnin përshëndetjen e drejtorit gjeneral, kur përpara skenës vjen një taxi klasike londoneze e markës Austin Martin. Me të erdhi drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz**. Publiku e përshëndeti me entuziazëm. Përshëndetja e tij i nxitte dhe i motivoi të



pranishmit për një pjesëmarrje sa më të madhe në Rallyn Europian të Europës.

Pas përshëndetjes bëri detyrën e tij të trishtuar. Njoftoi vdekjen e **Todd Maughan**, djalit të madh të Rex Maughan, i cili ishte prej pesëmbëdhjetë vitesh Drejtori i kompanisë sonë në Amerikën e Jugut. Turma prej mijëra vetësh qëndroi në këmbë në heshtje duke i bërë homazh.

Nga leksioni i **senior menaxheres Dr. Anna Schmitz** morrëm vesh se çfarë dhe si mund të veprojmë për mbrojtjen e organizmit tonë në verën e nxehët. Leksioni i saj u plotësua në mënyrë të shkëlqyer nga përvojat e moderuara të menaxherit **Dr. Otto Kertesz**. Të pranishmit morrën këshilla dhe rekomandime nga përvojat praktike të gjashtë mjekëve, veterinerëve dhe punonjësve të shëndetësisë për parandalimin e problemeve të ndryshme shëndetësore.

Mes duartrokitjeve dhe përgëzimeve entuziaste të publikut u zhvillua kualifikimi i **supervizorëve dhe asistent menaxherëve**.

**Menaxherja Hilda Pe-re** duke treguar përvojat e siguruar gjatë karrierës së saj u ofroi ndihmë të gjithë atyre që gjetën mundësi karriere në ndërtimin e biznesit. Leksioni i saj u kurorëzua nga kualifikimi i **Klubit të Sundimtarëve, menaxherëve dhe menaxherëve drejtues**. Bizneset,





por kryesisht prania e tyre në skenë janë provat më bindëse të faktit që në botën e Forever-it ka rregullisht histori suksesi.

**Zsolt Fekete** foli me besueshmërinë e drejtuesit dhe përvojat praktike të një safir menaxheri rreth thellësisë së rolit të marrdhënieve njerëzore.

Mëpas u dëgjua zëri dhe këngët e **artistes austriake Eva Karner** e cila krenohet me një karrierë ndërkombëtare. Ritmi i koreografisë së grupit të





kërcimtarëve **Positive Force** ishte në sinkron me rrahjen e mijëra zemrave në Arenë.

Në këtë atmosferë drejtuesit e programit shtrajnë pyetjen:

*-Kush dëshiron të vijë me ne në Londër...* – Afërsisht 40 vullnetar entuziast sulmojnë skenën. *- ...dhe me çfarë do të shkojmë?* – dhe përpara shikuesve të magjepsur, para skenës hyn me kujdes një autobus i vërtetë dy katësh me ngjyrë të kuqe. Vullnetarët e çuditur ftohen në autobus



nga drejtori gjeneral Dr. Sandor Milesz në shoqërinë e vajzave simpatike dhe elegante Glamour. Me këngën "Bye-bye në Londër..." autobusi niset mes përshëndetjeve të shumta – njëherë për njëherë në mënyrë simbolike – drejt Londrës. Edhe dyzetë ditë deri në ditën e kualifikimit. Edhe ti mund të jesh aty! Duhet ta pushtojmë Londrën si të parët e Europës. Kjo s'diskutohet!

**Senior menaxherja Tünde Hajcsik** duke na e sjellë shumë afër Rallyn European të

Londrës na prezanton mënyrat e mposhtjes së vështirësive. Nga fjalët e saj e kuptojmë: vështirësi kemi patur, kemi dhe do të kemi, por jo që të trembemi prej tyre, por që t'i mposhtim ato.

Drejtori i programit Andras Bruckner e humbet sigurinë vetëm njëherë. Tingujt e papritur të muzikës që dëgjohet tregojnë se: diçka nuk po shkon sipas planit të programit. Me të vërtetë. Kolegët e tij e përshëndesin në mënyrë të papritur me një tortë drejtuesin e programit që ka ditëlindjen.











Të urojmë shumë ditëlindje të tilla të gëzuara, Andras.

**Safir manexheri Istvan Halmi** foli rreth strategjisë bazë të ndërtimit të rrjetit. „ZGJERO!“ – theksoi në leksionin e tij, dhe me stilin e tij humoristik shpjegoi edhe se përse, dhe kryesisht në ç’mënyrë. Ishte një leksion bindës.

Si përfundim në skenë thirren dhe falenderohen gjithë lektorët për kontributin e dhënë në ngritjen e nivelit të aktivitetit. Drejtuesit e programit na e shtuan dëshirën për ditën e suksesit të shtatorit duke na treguar nja dy gjëra që priten. Me këtë rast prezantuan edhe drejtuesit e aktivitetit të ardhshëm: safir menaxherët **Agnes Krizso dhe Zolt Fekete**.

Aktiviteti u mbyll me kualifikimin e pothuajse dyqind asistent supervisorëve.

# Sonya®

## Colour Collection

2-3000  
HUF

**KI 119**  
Penel buzësh që mbyllet



**KI 135**  
Furçë dhëmbësh për udhëtim



**KI 111**  
Çantë kozmetike e zezë Sonya



**KI 194**  
Mini dozues

10 000  
HUF

**KI 134**  
Komplet manikyri



**KI 115**  
Pasqyrë me yje dhe zemra



**KI 114**  
Penel kabuki me gurë Sonya



**KI 139**  
Penel skuqës në formë gjysëm hëne Sonya



**KI 138**  
Minikomplet me 6 penele në roll



**KI 130**  
Kuti buzëkuqi e zbukuruar me gurë



Suksesi juaj është suksesi i skuadrës! Është një gëzim i madh kur punonjësit arrijnë nivele kualifikimi. Bëjeni më të paharrueshëm këtë rast të shkëlqyer. Zgjidhni nga paketat Sonya që gjenden këtu të cilat i shesim për herë të parë në Ditën e Suksesit të shtatorit.

**KI 194**  
Mini dozues



**5000  
HUF**



**KI 134**  
Komplet manikyri

**KI 114**  
Penel kabuki me gurë Sonya



**KI 94**  
Përdredhës Sonya



**KI 130**  
Kuti buzëkuqi e zbukuruar me gurë



**KI 140**  
Penel kabuki e zbukuruar me gurë



**15 000  
HUF**



**KI 127**  
Kuti Sonya e zbukuruar me Sonya

**KI 114**  
Penel kabuki me gurë




**KI 138**  
Minikomplet me 6 penele në roll

**KI 111**  
Çantë kozmetike e zezë Sonya



# Shqiponja në tokat aloe



**N**ë javën e parë të gushtit punonjësit që punojnë me 15 kodet më të suksesshme në botë morrën një ftesë nga drejtuesit e FLP-s. Nga Hungaria ftesë morri **Jozsef Szabo** dhe unë, **Miklos Berkics**, dhe të shoqëruar nga **Dr. Sandor Milesz** shkuam në Republikën Dominikane. Perla e detit të Karaibeve për ne ishte e njohur jo vetëm rreth klimës së mrekullueshme dhe bregdetit me bukuri piktoreske, por edhe se në këtë ishull gjendet toka prodhuese më e madhe e aloe-s së kompanisë sonë.

Prej vitesh të tëra është traditë Takimi i Shqiponjave (Eagle Summit). Më të mirët e botës shkëmbejnë përvojat me njëri tjetrin, si dhe është mundësi një javore për të biseduar me drejtuesit e kompanisë. Vlerën këtij takimi

special nuk ia jep vetëm shkëmbimi i opinioneve, por edhe mësimet që jep drejtorja qendrore në mënyrë që ta vlerësojmë më shumë ndërtimin e rrjetit dhe atë që na siguron Marketingu i Forever-it. Është e lehtë të jesh drejtues kur në një ambient të njohur duhet të kryesh detyra rutine. Por si sillemi në situata të papritura? Me çfarë qëndrimi i kryejmë detyrat e çuditshme që na dalin në situata të papritura? Sa e vlerësojmë punën e të tjerëve?

U zgjuam në orën 3 të natës dhe pasi udhëtuan një orë e gjysëm me autobus mbërritëm në plantacion. Pamë lindjen e djellit në fushat e pafund të aloe-s, bëmë disa fotografi vetë dhe me grupin, pastaj i hymë punës. E bëmë vetë, pa roba mbrojtëse dhe kaskador. Mblodhëm gjethet aloe për

orë të tëra në verën tropikale 40 gradëshe. Gjembat e bimëve na çorrën të gjithë duke na gjakosur. Pas mbledhjes erdhi grumbullimi, e ke parasysh, kjo është pjesa e filmit kur vjen traktori dhe ngarkohet me prodhimin e sapombledhur. Pastaj në rimorkon e makinës bujqësore shkojmë në fabrikën e përpunimit, pasi të kujtohet, brenda 3 orësh duhet përpunuar që të parandalohet oksidimi... dhe pastruam, lamë, premë gjethet, njëlloj si në film. Në fillim më pëlqeu me të vërtetë... argëtim i mirë! Por me kalimin e kohës mendova që tani dikush le të thojë që mjaft djema, falemnderit!

Aty, në plantacione dhe në fabrikën e përpunimit njerëzit punojnë 10 orë në ditë dhe 6 ditë në javë. Punojnë shumë në mënyrë që produktet të përfundojnë tek njerëzit në

143 vende të botës. Sot e shikoj me më shumë respekt bidonin e verdhë, sepse e di që ky produkt vjen në tryezat tona falë punës së disa duarve të vullnetshme. Mësova shumë në këtë udhëtim. Çfarë është e vështirë? Nuk vjen? Nuk të intereson? Të dukem i marrë? Çfarë është kjo para punës që njerëzit bëjnë që produkti të shkojë deri në magazinë. Prej aty puna jonë është lodër fëmijësh. E shtrenjtë??? "Mbidhe veten", ka uje çmimesh në Dominikë! Aloe Travel Service (ATS) të siguron me çmim të ulët strehim, kurse Zyra e Biletave të Avionit Phonix biletat fluturimi.

Një bidon Xhel Aloe! Unë e di se çfarë vlera ka!



**MIKLOS BERKICS**  
*Diamant – safir  
menaxher*

Kur ishim në plantacion Jozsi Szabu u përkul dhe hodhi  
para meje një grusht dhe – këtu fillon gjithçka – tha.  
Prej kësaj toke jetojmë Miku im! E kuptova mësimin!  
Do e bëj detyrën time! Falemnderit Forever!





**T**ë dashur kolegë të rinj, "të vjetër", dyshues, të interesuar, të gjithë!

Kaloi një vit dhe është një ndjenjë e mirë që përsëri udhëtuam, natyrisht që me shpenzimet e KOMPANISË.

Më shumë se 100 tregëtarë tepër entuziast, apo si themi ndryshe "anëtarë të Forever-it", u shplodhën, mësuan, morrën pikësynime të reja, u njohën dhe u mbushën me energji në Dallas, dhe pyetja është që Ti ku ishe, përse nuk erdhe me ne?

Kur shumë njerëz thonë që është krizë, s'ka para dhe





# Dhe prapë!!!!



njerëzit janë të varfër, atëherë vras mendjen që përse nuk e shfrytëzojnë mundësinë e ofruar, përse nuk veprojnë sikur gjithçka të ishte rregull, ndërkohë që zgjedhin ndërmjet çeqeve të verdha siç bënim edhe ne përpara 10 vitesh.

Gjatë një udhëtimi të tillë njeriu njihet me histori të ndryshme, kështu ndodhi edhe tani. Një zonjë nga ANGOLA foli rreth fillimeve, rrethanave dhe sukseseve. E di që aty kërcasin akoma armët, e di që aty njerëzit jetojnë në një gjendje të paimagjinueshme, që rehati = kasolle teneqesh, dhe prapë DËSHIROJNË NJË JETË TJETËRI!

Në këtë pjesë të botës ndoshta "rrethanat" janë më të mira, e di, për të gjithë situata aktuale është e vështirë, por!

Ku do të ndodheshim ne, familja Bako, nëse 10 vjet më parë nuk e kapim dorën që







na u zgjat, NUK E BESOJA që jemi në gjendje ta bëjmë, POR GJITHÇKA E BËMË ASHTU SIÇ NA THA NJERIU I MADH – ZSOLT FEKETE – më beso kishte dhe ka edhe sot njerëz të cilët na përqeshin ne dhe atë që bëjmë ne – pasi nuk e kuptojnë – dhe rezultati është i pashmangshëm.

ZGJOHU, ekziston mundësia, ekziston aloje, ekziston rrugëzgjdhje, ekziston ndihmë, ekziston një kompani e cila të shpërblen për gjithçka, çështja është që A DËSHIRON

NJË JETË MË TË MIRË? DËSHIRON PARA? DËSHIRON SIGURI PËR FAMILJEN TËNDE? Përgjigju me: PO!!!!

Shiko fotografinë, sipas teje a ka mjaft "mall"? Ka plot, Rex të kërkon vetëm ta përhapësh lajmin kudo dhe të gjithëve, dhe për këtë të shpërblen! Ekziston një forcë dhe siguri e pabesueshme prapa nesh, ki besim tek sponsori – nëse nuk beson tek vetvetja – kaq e thjeshtë është, bëj gjithçka që të thotë, mos debato kot, të do vetëm të mirën, BËJE!!!







Falenderoj që m'u dha mundësia të takohem me sfida më të madhe të jetës sime, falenderoj që jam anëtar i SKUADRËS, falenderoj për durimin.

Të uroj TY, që po lexon këtë revistë, të shikosh THELBIN, TË DALLOSH DORËN NDIHMËSE, DHE TË JETOSH NJË JETË MË TË LUMTURI!



**MARTI DHE JOZSI BAKO**  
senior menaxherë



# Traditional Post Rally







## Çfarë të pëlqeu më shumë?

**P**ër shkak të mundësive të shumta të kalimit të kohës u drejtova të gjithëve pyetjen: “Çfarë të pëlqeu më shumë në Silver Rally, cila ishte mbresa jote më e madhe?” Dhe këto përgjigje i hodha në letër.

**Jozsi Szabo, safir menaxher:** Kjo është e mrekullueshme, por duhet të flas patjetër rreth Eagle Summit

(Takimi i Shqiponjave – mbi 7500 cc) i cili na mësoi përsëri përuhlen. Nga ora 5 e mëngjesit “korrëm” të mbjellat bashkë me puntorët. Ishte shumë e rëndë: mushkonja, vapë, përkulje të cilën duhet ta bësh edhe me precizitet që të mos dëmtohet gjethja. Kjo ditë na mësoi që si të përgjigjemi nëse dikush ankohet për çmimin e xhelit (siç bëra

edhe unë në atë kohë): Gjysma e xhelit është djersë, miku im. Mos e gjyko para kohë!

**Vera & Stevo Lomjanski, diamant-safir menaxherë i:** Edhe Rally është rezultati i një pune fantastike në skuadër. Çdo fjalë dhe veprim i drejtuesve të kompanisë tregon se punojnë me shpirt e zemër. Në çdo moment e ndjejmë që jemi në biznesin e

dashurisë. Nga leksionet mësuam shumë. Shumë të tjerë duhet të ishin këtu, vetëm që atyre u mungojnë „kilometrat e tepërta”.

**Robi Varga, diamant-safir menaxher:** Ky biznes kërkon përulje, këtë pashë nga drejtuesit. Ajo që dallova tani: puno vazhdimisht dhe guxo të ëndërrosh gjëra të mëdha. Me fjalët e Aidan: “Ndryshim. Duhet





Ndërkohë që në Super Rally jemi bashkë pothuajse deri në fund — në aktivitet, në ngrëniet dhe programet e përbashkëta — Silver Rally është një pushim, shpłodhje, rigjenerim i plotë. Skuadra është bashkë vetëm në darkën e lamtumirës dhe në trainimet e paradites. Gjatë periudhës së mbetur secili e organizon vetë programin, për të cilin sigurisht marrim ndihmë: për ne ishte ngritur një një zyrë organizmi programesh.

të bësh ndryshime! Me atë që arrite deri tani u bëre ky që je, nëse dëshiron më shumë, duhet të bëhesh njeri tjetër, pra duhet të bësh ndryshime!”

**Aranka Vagasi & Andras Kovacs, diamant-safir menaxherë:** MUDANCA – trainimi i Rex Maughan-it në Dallas, sipas të cilit ndrysho mënyrën e të menduarit, krijo diferencë rreth vetes – “diferencë pozitive”. Kjo është një këshillë e thjeshtë të cilët kam për ta ndjekur edhe unë.

Ejani me ne në Denver dhe San Francisco në vitin 2010!!!

**Agj Krizso, safir menaxherë:** Ambienti ishte mahnitës. Dinjiteti i palëkundshëm i maleve – u magjepsëm nga pamja e mrekullueshme. Ishte një vend për rigjenerim të vërtetë.

**Adolf L. Kosa, safir menaxher:** Çfarë më pëlqeu më shumë

përveç xhakuzit të dhomës? Kur morra vesh se në Conquistador Club të korrikut merrnin pjesë tre vetë nga skuadra ime.

**Istvan & Rita Halmi, safir menaxherë:** Ne vetëm kishim dëgjuar nga “të vjetrit e mëdhenj”, nga ata që kishin qenë në Super Rallyt e mëparshëm që si ishte kur nga hoteli i çonin me autobus drejt e në aeroport dhe ngjiteshin në avion pa asnjë lloj kontrolli. E dimë që në 11 shtator 2001 bota ndryshoi, dhe që atëherë në avion s’mund të marrësh as ujë për të pirë apo as tub kremi më të madh se 100 ml. Edhe tani në Dallas autobusi shkoi në aeroport, por jo në vendin zyrtar të ngjitjes, por në pjesën private, valixhet dhe ne u ngjitëm menjëherë në avion (na kontrolluan vetëm me detektor hekur), ku në kokat e sedilieve

ndodhej simboli i shqiponjës. E pabesueshme se sa i aftë është Rex! Falemnderit!

**Gizi dhe Marius Botis, safir menaxherë:** Ajo që na mbush gjithmonë me gëzim dhe çudi është kujdesi, dashamirësia dhe mikpritja e kompanisë, dhe kemi qenë njëmbëdhjetë herë në Rally, por kjo s’ka ndryshuar.

Na pëlqen mesazhi i këtij viti i cili flet rreth ndryshimit personal.

Gëzohemi që nga skuadra jonë marrën pjesë shumë vetë edhe në Silver Tour Rally.

Kurse për ty, që po lexon këto rreshta, mesazhi im është: nëse dëshiron të vish me ne në të ardhmen, merr vendimin, planifikoje dhe realizoje! Kjo është e mundshme, je i aftë ta bësh dhe e meriton.

**Bosko & Maria Borus, safir menaxherë:** Silver Rally është

i lezetshëm, një shpłodhje dhe rigjenerim i vërtetë, por trainimi 3 orësh – me 5 lektor – ishte fantastik!

**Zsolt & Noemi Fekete, safir menaxherë:** Sivjet ishim për herë të 6-të në Silver Post Rally. FLP nga viti në vit na bën surpriza të reja...

Lake Tahoe është i shumë i bukur! I përket vendeve që të gdhenden në kujtesë. I pastër, i lashtë, një gur i çmuar i botës që të bën për vete.

Shijam lëkundjen e dallgëve në katamaran, dëgjuam përshpëritjen e erës së egër...

Argëtuam së bashku me drejtuesit që përfaqësojnë 9 milion e gjysëm anëtarë të familjes FLP nga gjithë vendet e botës.

Skuadra hungareze me skandinaven, braziliane me afrikanen jugore, hollandeze me



malajzezen, amerikane me slovaken, kanadeze me rumunen.

Më shumë se 400 njerëz të cilët ecin së bashku në të njëjtin drejtim, mendojnë së bashku që: MAKE A DIFFERENCE!

Të presim vitin e ardhshëm në San Francisco!

**Teca Herman, senior menaxherë:** Më mahnitë kujdesi, dashamirësia, përkushtimi i kompanisë. Mbi lartësinë 2900 m ajri është pak i rrallë, por shumë i pastër, ashtu si kompania FLP.

**Sanyi Toth & Edina Vanya, soaring menaxherë:** Ishte mahnitës ambienti, mikpritja, vëmendja e kushtuar ndaj miqve, organizimi i programit dhe shoqëria e mirë. U shplohëm, u rigjeneruam që pastaj të punojmë me forca të reja.

**Zsolt & Anita Leveleki, senior menaxherë:** Mbresa më e madhe, nëse mund të zgjedhim mes tyre, ishte shëtitja me helikopter. Na u shfaq përpara një pamje shumë e bukur. Malet, uji i kaltër, shtëpitë e ndërtuara mes bredhave dhe vetë ndjenja e fluturimit – ishte e paharrueshme.

**Vili Halomhegyi, senior menaxher:** Ishte një ndjenjë e mrekullueshme të kaloje kohën bashkë me njerëz të shkëlqyer në takimin e madh ndërkombëtar të FLP-s. E ndjej me të vërtetë që m'u rrit niveli i energjisë dhe i marr përsipër pa frikë sfidat. Qëllimi im është që t'ua ofroj sa më shumë njerëzve mundësinë e ndryshimit. Mendoj me shumë dashamirësi për njerëzit të cilët me punën e tyre kontribuan në krijimin e kësaj mbrese.

**Hajni Senk & Klari Herlendy, senior menaxherë:** (opinion i tyre ishte i njëjtë)

Vendi ishte i përshtatshëm për t'u menduar dhe rigjeneruar. Me fjalët e Gregg-ut: (Bëhu i veçantë në diçka!" Mësuam përsëri përluljen dhe respektin. Zona ka një forcë magjike, dhe kjo erdhi në momentin më të mirë. Njëlloj si ajo kur për biznesin thonë që është diçka aq e bukur sa që s'mund të ekzistoj. Por ekziston! Këtë përjetuam këtu.

**Csaba Juhasz & Enikő Bezeg, senior menaxherë:** Ishte shumë gjë e bukur të ishe aty për

herë të parë – duhet të bëhemi anëtarë të përhershëm të Silver-it! Mbresa jonë më e madhe ishte: ekskursioni në lartësinë 3300 m me sponsorët, dhe kalorësimi për herë të parë.

**Tamas & Eva Budai, soaring menaxherë:** Ngjitem lartësi madhështore – 3300 m – dhe gjithë këtë e bëmë me kolegët e sponsorizuar nga ne!

**Marika & Zsolt Rozsahagyi, soaring menaxherë:** Shijua frytin e punës sonë në vendin e pushimit më me emër të USA-s, ku gjithë viti është sezon. Mund të zgjidhni programe të shkëlqyera, pushuam dhe u rigjeneruam sipas dëshirës. Provuam përsëri se FLP e shpërblen atë që ka rezultat. Është ndjenjë e mirë të jesh bashkë me më të mirët, të jesh "përfaqësues i Forever-it". Mezi presim që nga skuadra jonë të marrin pjesë sa më shumë vetë në Silver-in e ardhshëm.

**Teca Samu & Andras Bruckner, soaring menaxherë:** Ambienti ishte mahnitës, klima ashtu siç mund ta dëshirosh: rreze të shkëlqyera dielli, 22-28°C, erë e lehtë – vend ideal për rigjenerim. Në trainim – 5 lektor nga 4 vende të botës – mësuam shumë. Dëgjua përshebull në mënyrë të hollësishme metodën e punës së brazilianëve – në vitin 2008 ata ishin më të mirët – dhe arritëm në konkluzionin që bëjnë të njëjtën gjë që bëjmë edhe ne. Atëherë ku është ndryshimi? Tek fakti që ata e përsërisin shpeshherë të njëjtën gjë ☺! Pra – **ndryshimi** – mesazhi i kompanisë për këtë vit, për këtë kemi nevojë. Dhe morrëm gjithçka për këtë. Falemnderit Rex, Gregg, Aidan! Të tjerat varen vetëm nga ne.

Ti, lexues i dashur, mos mendo se ky është vetëm privilegji ynë! Rex, Gregg dhe Aidan të pret edhe Ty në Super dhe Silver Rallyn e ardhshëm, sepse edhe Ti e meriton! Mund ta bësh, vetëm prano ndryshimin dhe fillo ta zbatosh – në vetvete!

Në letër e hodhi:



**DR. TEREZIA SAMU**  
soaring menaxhere

# BERRY Bar

## Krijo trend kokteilesh me pijet Aloe!

S'është diçka e zakonshme që të festojmë me një Forever Shake Party një prezantim të suksesshëm, një kualifikim apo një aktivitet familjar dhe takim miqësor. Nëse na pëlqen idea, atëherë ta realizojmë!

**P**ërse do të arrijmë me këtë sukses shumë të madh? Sepse ndoshta në skuadër vetëm NE i organizojmë Aloe Coctail Party miqve dhe punonjësve tanë.

Kjo do të jetë e veçantë, trendi dhe e paharrueshme për të gjithë.

Çfarë mendon lexues i dashur, nga e di unë këtë gjë? Po, nga përvoja. Dua

t'ju përmend vetëm një shembull. S'ka kaluar shumë kohë që punonjësit tanë menaxher që punojnë në Cegled patën jubile, dhe në fund të prezantimit të 100-të familjar "Dhoma e hapur" i shërbyen mysafirët pjesëmarrës me kokteil Berry-Bar. Ishte një surprizë dhe sukses i madh, dhe natyrisht edhe shumë pikë.

Nëse ndonjëherë ke dëgjuar ndonjë pretext të tillë që dikush nuk e pi xhelin sepse "s'i pëlqen shija", tani përzijei pa frikë një koktejl të bukur e të shijshëm.

Të garantoj që ka për ta pëlqyer shumë.

Dëshiroj të të ndihmoj që NE të gjithë të bëhemi mikpritësit e mirë të FLP-s. Jo vetëm në një rast të veçantë, por ndoshta edhe çdo ditë ia vlen t'i përgatisim këto

gjëra të shijshme për veten dhe familjen tonë. Ta realizojmë pa frikë, sepse ia vlen t'i kushtosh kohë.

Në aktivitetet me skuadrën, mbrëmjet e kualifikimeve, prezantimet familjare, takimet miqësore, por edhe në diplomimin e fëmijëve tanë apo me rastin e ngjarjeve të tjera familjare mund t'u bëjmë qejfin të gjithëve ma gjëra të shijshme të veçanta dhe të shëndetshme. Mysafirët tanë do të jetë e lehtë t'i magjepsim me një koktejl pa alkool të përgatitur thjeshtë me pijet Forever. Dhe gjithashtu me këtë gjest dhe mënyrë të



**U uroj të gjithëve një ditë të bukur e të shëndetshme!**

veçantë përgatitjeje mund t'i bëjmë më të pëlqyera, më të shijshme dhe më të njohura pijet Forever.

FLP edhe në këtë fushë ofron një zgjedhje të gjerë e të pasur. Në zyrat tona pa vlerë pikësh gjendet një bllok i shkëlqyer me titullin PËRZIE!, ku një radhë e tërë recetash Forever Lite Shake presin që t'i realizojmë. Ia vlen t'i sigurosh dhe t'i provosh këto gjëra të shijshme.

Të imagjinojmë kur në fund të një dite të gjatë e të lodhshme, dëshirojmë të shplohemi ose t'i bëjmë qejfin apo një surprizë të veçantë partnerit tonë, për këtë ju rekomandojmë që krahas një banjoje aromatike relaksuese spa t'i përgatisim edhe një koktejl shëndeti. Rezultati është i garantuar.

Miku im i dashur, para se të ngrihesh i udhëhequr nga kjo ide dhe të nxitosh për t'u regjistruar në shkollë apo në kurs mixer-bartender, të lutem mos e bë. Më mirë nxirr në pah fantazinë dhe kreativitetin tënd. Në radhë të parë do të kesh nevojë për këto, dhe natyrisht për pijet Forever.

Të shohim se çfarë na nevojitet në Berry-bar për përgatitjen e kokteileve të shëndetit, long-drinkeve Aloe.

Bima Aloe ka origjinë tropikale dhe subtropikale, prandaj asaj i përshtaten me harmoni lëngjet pa gaz të bimëve që vijnë prej këtyre zonave klimatike, por mund të përdorim pa frikë edhe lëngjet e bimëve që prodhohen në vendin tonë. Mua për vete më pëlqen më shumë përzjerja e Berry nektar me lëng qershie. Për mua shija e ëmbël si boronicë e aloe-s shkon shumë me aromën e thartë të qershisë, por ndoshta Ti ke botë tjetër shijesh, prandaj zgjidh më të përshtatshmen për veten tënde.

Kokteili Berry-Bar s'është gjë tjetër veçse një pije e përgatitur nga përzjerja e të paktën dy lëndëve bazë dhe e zbukuruar nga jashtë.

Për zbukurim mundësisht të përdorim fruta të cilat i përmban kokteili dhe janë në harmoni me ngjyrat e pijes së përgatitur. E rëndësishme është të jenë të freskëta dhe të ngrënshme. Të mos e teprojmë, por të ketë efekt!

Variantet e pafund të kokteileve i kufizon vetëm fantazia dhe kreativiteti i njerëzve. Dhe suksesi është i pashmangshëm.

Për përgatitjen përveç pijeve Forever nuk nevojiten shumë gjëra të tjera

shtesë apo pajisje të veçanta, sepse këto gjenden pothuajse në çdo shtëpi ose mund të sigurohen thjeshtë.

**Pijet bazë që rekomandohen:** Berry Nectar, Aloe Vera Gel, Forever Aloe Bits n' Peaches, Forever Freedom, Pomesteen Power, ujë burimi Sirona, Forever Bee Honey, Forever Lite dhe Ultra Lite.

**Lëngje frutash me fibra dhe të filtruara:** /mundësisht të zgjedhim lëngje cilësore, pa sheqer dhe lëndë konservuese/ Lëng ananasi, portokalli, tropikal, marakuje, mangoje, grejpfriti, pjeshke dhe kajsie, rrushi /i bardhë, i kuq/, molle, qershie, nektari qershie, lëng limoni 100%

**Fruta të freskëta e të ngrënshme për zbukurim:** ananas, portokall, limon, limon jeshil, pjeshkë, rrush, qershi kokteili /e kuqe, e verdhë, blu/, copa të mëdha e të vogla akulli

**Plotësues, pajisje:** zbukuroes kokteili, shpatë plastike qershie, mbledhës, shkop kokteili, tub thithës, peceta.

Gota long-drink (2,5-3 dl), Forever Lite Shaker (produkt pa vlerë pikësh), lugë përzierëse, lugë matëse, thikë, gërshtë, dërrasë për prerje.

## Disa receta për përgatitjen e tyre

### Sunny drink

#### /pija Rrezja e diellit/

1 dl Forever Aloe Bits n' Peaches

1 dl lëng pjeshke

0,5 dl nectar kajsie

0,2 dl lëng limoni 100%

Zbukurim: rrotë limoni, qershi e kuqe kokteili ose një copë pjeshke e freskët.

Në një gotë long-drink hedhim 2-4 copa akulli, pastaj Bits n' Peaches, lëngun e pjeshkës, kajsisë dhe limonit. E përziejmë të gjithë, e zbukurojmë dhe pas kësaj mund të ofrojmë një pije të mirë.

### Champion

1 dl Aloe Bits'n Peaches

0,4 dl lëng kajsie

0,4 dl nectar qershie

0,4 dl lëng multi-vitamin

1-2 pika lëng limoni 100%

Zbukurim: një copë pjeshke, limoni, lëkurë portokalli në formë spirali

Marrim një gotë, e mbushim gjysëm me copa akulli, pastaj hedhim të gjithë lëngjet e frutave dhe Aloe Bits'n Peaches. Këto i përziejmë, pastaj frutat i vendosim në shkop dhe me këtë ofrojmë pijen. Japim edhe një tub thithës.

### Ananas Sour

0,5 dl Aloe Vera Gel

1,5 dl lëng ananasi

0,5 dl lëng limoni 100%

1 lv Bee Honey

Zbukurim: ¼ copë ananasi ose një rrotë limoni, qershi e kuqe kokteili

Marrim një shaker të mbushur gjysëm me akull dhe hedhim në të lëng ananasi, lëng limoni, mjalt dhe xhel Aloe Vera. I përziejmë mirë të gjitha, pastaj i filtrojmë në një gotë dhe pija është gati për t'u ofruar.

### Ëndërr ananasi

0,5 dl Aloe Vera Gel

2 lgj tul ananasi

1,5 dl lëng ananasi

4 lv Bee Honey

1-2 pika aromë vanilieje

Ujë mineral Sirona

Zbukurim: ¼ copë ananasi, qershi e kuqe kokteili

Hedhim në shaker tulin e ananasit, pastaj i shtojmë lëngun e ananasit, aromën e vanilies dhe xhelin Aloe Vera. E përziejmë mirë të gjithë, pastaj e hedhim në gotë. Si përfundim e mbushim me ujë mineral Sirona, e zbukurojmë me një copë

ananasi dhe qershi kokteili, dhe pija është gati për t'u ofruar.

### Angel's Kiss

1 dl Berry Nectar

0,5 dl lëng molle

1 dl lëng qershie

0,5 dl lëng limoni 100%

Zbukurim: rrotë limoni jeshil, qershi e kuqe kokteili

Vendosim akullin në shaker, hedhim mbi të nectar Berry, lëng molle, lëng qershie dhe e përziejmë të gjithë. Si përfundim e hedhim në gotë, e zbukurojmë dhe është gati për t'u ofruar.

### Ananas Mint Coollet

0,5 dl Aloe Vera Gel

1,5 dl lëng ananasi

0,6 dl Bitter Lemon

2 pika shurup menderi

Zbukurim: ¼ copë ananasi, qershi e kuqe kokteili, gjethe menteje

Marrim një gotë, hedhim brenda akull, pastaj e mbushim me lëng ananasi, shurup, Bitter Lemon dhe xhel Aloe Vera. E përziejmë mirë të gjithë, pastaj e zbukurojmë me ananas, dhe pija është gati për t'u ofruar.

### **Bahamas**

1,5 dl lëng molle  
0,2 dl lëng limoni 100%  
0,4 dl Pomesteen Power  
1 lv Bee Honey

Zbukurim: një copë limoni jeshil, qershi e kuqe kokteili

Marrim një gotë, hedhim brenda akull, pastaj e mbushim me lëng molle, lëng limoni dhe pomesteen. E përziejme mirë të gjithën, e zbukurojmë me limon jeshil, dhe është gati për t'u ofuar.

### **Atomic cat**

1,5 dl lëng portokalli  
1 dl Freedom  
Ujë mineral Sirona

Zbukurim: 1 rrotë portokalli, qershi kokteili, copa akulli

Marrim një gotë dhe e mbushim plot me akull. I hedhim lëng portokalli dhe Freedom. E ofrojmë të zbukuruar me një rrotë portokalli dhe qershi kokteili.

### **Berry Plant (fabrikë boronicash)**

0,5 dl Berry Nectar  
1,5 dl lëng qershie  
0,3 dl lëng limoni  
2 lv Bee Honey

Zbukurim: rrotë limoni, qershi kokteili (jeshile, e verdhë)

Hedhim në shaker akull të thyer, pastaj e mbushim me Berry nectar, lëng qershie, lëng limoni dhe mjaltë. E përziejme mirë të gjithën, pastaj e hedhim në një gotë. Si përfundim e zbukurojmë me një rrotë limoni dhe qershi kokteili, dhe është gati për t'u ofruar.

### **Bongo**

0,7 dl lëng ananasi  
0,4 dl lëng mangoje  
0,2 dl lëng limoni  
0,3 dl lëng portokalli  
0,5 dl Aloe Vera Gel

Zbukurim: ¼ copë ananasi, qershi kokteili

Marrim një shaker të mbushur gjysëm me akull dhe hedhim në të të gjitha lëngjet e frutave dhe xhelin AV. E përziejme mirë të gjithën, pastaj e filtrojmë në një gotë. Si përfundim e zbukurojmë me fruta, dhe pija është gati për t'u ofruar.

### **Flamingo**

0,5 dl Berry nectar  
0,5 dl Pomesteen  
1 dl lëng ananasi  
0,2 dl lëng limoni  
Ujë mineral Sirona

Zbukurim: 1 copë limoni jeshil, qershi kokteili, copa akulli

Marrim një shaker dhe e mbushim gjysëm me akull. Hedhim në të lëngjet e frutave. E përziejme duke e trazuar fort, pastaj të filtrouar e ofrojmë në një gotë plot me akull të zbukuruar me një copë limoni jeshil.

### **Forever Drink Olympic**

0,5 dl Aloe Vera Gel  
0,5 dl Pomesteen  
0,6 dl lëng rrushi i kuq  
0,4 dl lëng rrushi i bardhë  
0,1 dl lëng limoni  
3 lv mjaltë  
Ujë mineral Sirona

Zbukurim: verige rrushi, bar limoni

Marrim një shaker të mbushur gjysëm me akull dhe e hedhim në të lëngjet e rrushit, xhel, Pomesteen, lëng limoni, mjaltë dhe ujë mineral. E përziejme mirë të gjithën, pastaj e filtrojmë në një gotë. Pas kësaj gotën e mbushim me ujë mineral. Si përfundim e zbukurojmë me fruta dhe bar limoni, dhe pija është gati për t'u ofruar.

### **Eldorado 4 you**

0,4 dl Aloe Vera Gel  
0,4 dl Freedom  
0,4 dl lëng portokalli  
0,4 dl lëng maracuje  
0,4 dl lëng ananasi

Zbukurim: qershi kokteili (e kuqe), copë portokalli, gjysëm ananasi

Marrim një shaker të mbushur gjysëm me akull dhe e hedhim në të lëngjet e frutave, xhel dhe Freedom. E përziejme mirë të gjithën, pastaj e filtrojmë në një gotë. Si përfundim e zbukurojmë me fruta dhe pija është gati për t'u ofruar.

### **Yellow-jacket (xhaketa e verdhë)**

0,5 dl. AV. Gel  
1 dl lëng grejpfruti  
1 dl lëng ananasi  
0,2 dl lëng limoni

Zbukurim: ananas, qershi kokteili e kuqe, copa akulli

Marrim një shaker dhe e mbushim gjysëm me akull. Hedhim në të lëngjet e frutave, xhelin AV, pastaj e përziejme duke e trazuar fort. E hedhim në një gotë plot me akull duke e filtrouar. E zbukurojmë sipas shijes.

U uroj të gjithëve guxim dhe sukses në përgatitjen e kokteileve!  
GO FOREVER!

*Me respekt dhe dashamirësi*



**MARIA BALLA**  
menaxhere



# KLUBI I SUNDIMTARËVE

Dhjetë distributorët e parë të muajit korrik 2009 sipas pikëve personale dhe të non-managerit




## Hungaria

1. Klaj Ágnes
2. Balogh Tünde
3. Senk Hajnalka
4. Ferencz László
5. Lapicz Tibor dhe Lapiczné Lenkó Orsolya
6. Visnovszky Ramóna dhe Bognár Gábor
7. Sebők Attila
8. Hertelendy Klára
9. Vágási Aranka dhe Kovács András
10. Damásdi Ildikó

## Serbia, Mali i Zi

1. Petrovic Milena dhe Petrovic Milenko
2. Strboja Jovanka dhe Strboja Radivoj
3. Dr. Tumbas Dusanka
4. Zurka Dragana dhe Zurka Radisa
5. Jakupak Vladimir dhe Jakupak Nevenka
6. Lozajic Dimitrovski Snezana dhe Dimitrovski Hristo
7. Zecevic Boban dhe Zecevic Dusanka
8. Dr. Sonja Jovic Randjelovic dhe Randjelovic Dragan
9. Jurisic Dr. Radmila dhe Jurisic Predrag
10. Maravic Milena dhe Maravic Milan



# CONQUISTADOR CLUB




## Kroacia

1. Jurovic Zlatko dhe Jurovic Sonja
2. Petrovic Jasminka dhe Petrovic Mirko
3. Zantev Andrea
4. Korenic Manda dhe Korenic Ecio
5. Grbac Silvana dhe Grbac Vigor
6. Banic Nedjeljko dhe Banic Anica
7. Blazevic Bojana
8. Stipetic Anton
9. Buterin Goranka
10. Trvdinic Bozica

## Bosnia-Hercegovina

1. Varajić Savka
2. Mustafić Subhija és Mustafić Safet
3. Marić Slavica
4. Varajić Zoran és Varajić Snezana
5. Njegovanovic Vaselije
6. Franjić Dr. Goran
7. Marković Danijel
8. Njegovanović Svetlana
9. Dr. Petković Nedeljko és Petković Milojka
10. Marković Ljiljana és Marković Stojan



## Sllovenia

1. Varajic Savka
2. Mustafic Subhija dhe Mustafic Safet
3. Maric Slavica
4. Varajic Zoran dhe Varajic Snezana
5. Njegovanovic Vaselije
6. Franjic Dr. Goran
7. Markovic Danijel
8. Njegovanovic Svetlana
9. Dr. Petkovic Nedeljko dhe Petkovic Milojka
10. Markovic Ljiljana dhe Markovic Stojan

# Të gjithë në rrugën drejt suksesit



## Nivelin e senior menaxherit e arritën: (sponsor)

Iskra Rinalda dhe Iskra Luciano (*Laginja Flavia*)

Sebők Attila (*Sebők Andrea*)



## Nivelin e menaxherit e arritën: (sponsor)

Bellér Szilvia dhe Tari Attila (*Damásdi Ildikó*)

Burger Katalin (*Berkics Mikós*)

Dobai Lászlóné dhe Dobai László (*Klaj Ágnes*)

Minorits Péter dhe Minoritsné Bogár Andrea (*Sebők Attila*)

Petrovic Jasminka dhe Petrovic Mirko (*Iskra Rinalda dhe Iskra Luciano*)

Végh Karina (*Senk Hajnalka*)



## Nivelin e asistent menaxherit e arritën:

Duday István

Faragó Károly

Keneseiné Szűcs Annamária

Kovács Csaba és Bakos Mária

Mihók Andrea

Nagy Gábor és Megyeri Erna

Sefcsik Ibolya

Szántó Mihályné

Szabó Hajnalka

Topor Pal Judit

Wippelhauser Zsolt

Zantev Andrea



## Nivelin e supervizorit e arritën:

Angyal Roland

Antal Szűcs Éva

Bárdosné Kiss Erzsébet

Békés Éva

Baron Ágnes

Bencsik Zoltánné dhe

Bencsik Zoltán

Bohus Mixtaj Mgr. Judit dhe

Bohus Lorand

Božić Petra dhe Božić Marijan

Csertusné Kocsis Ágnes

Csiba Annamária

Czakó József Béláné

Disznós Imre

Dr. Fullér Istvánné

Dr. Jakab László

Dr. Képes Ildikó

Dr. Prókay Edit dhe Dr. Lipták József

Dudas Oliver Mudr.

Farkas Ladislav Ing. dhe

Farkas Csizmadia Zsuzsa

Gál Szilvia

Gabnai Gábor

Ganza Jevgenyija

Gorazova Adriana

Győriné Ajzner Márta

Hacsó Anikó

Hegyiné Tauber Györgyi dhe Hegyi Péter

Hovanez Jenő

Ilić Andjela

Iloskics Mátyás dhe Iloskicsné Kadiró Tünde

Jordán Mária

Jovičić Milena dhe Jovičić Dragorad

Juhász Judit

Kéri László

Kalló István

Kecskés Adrienn

Kerese Lajosné

Keresztúriné Láng Marianna

Kis Zoltán dhe

Vatai Tünde

Kiss Róbert dhe Kissné Beta Mária

Kiszely László

Klár Anna

Kollár Pál dhe Bozsik Eszter

Kovács Lászlóné

Kovács Szabolcs dhe

Kovács Szabolcsné

Kovács Judit

Kovácsné Tardi Tímea dhe Kovács Péter

Krajer Vilmosné dhe Krajer Vilmos

Kun-András Irma dhe Kun-András Márton

Lang Gábor

Lendvay Péterné dhe

Lendvay Péter

Lukač Svetlana

Maletić Branka

Miličević Marica dhe

Miličević Zoran

Milovanović Marijana

Molnár Nikolett

Monoki Józsefné dhe Monoki József

Nagy Károly

Nagy Tibor

Nagyné Monoki Mónika dhe

Nagy József

Oszvald Péter János

Pajer Anita

Puskás Anikó

Puskásné Cseperka Ágnes

Radojković Vidosava

Rados Tibor

Radovanović Slavica

Reményi Éva

Repkáné Ajzner Éva

Rózsáné Fejér Krisztina dhe

Rózsa Zoltán

Schupkégel Lászlóné

Stipetić Anton

Suljević Muamer

Szabó Csaba Dánielné dhe

Szabó Csaba Dániel

Szalai Bernadett

Szamay Judit

Tuboly Zsuzsanna dhe

Vörös György

Tógyer Andrea

Tóta Lajosné dhe Tóta Lajos

Tóta Gábor

Tóth Károlyné dhe

Tóth Károly

Tóth Attila József

Uzsák Margit

Valenta Marta

Varga Zoltán

Vertich Lilla

Vidó Irén

Zemlényi Katalin

Zorić Danijela dhe Zorić Bojan





## Fituesit e programit motivues për blerjen e makinës:

### Niveli 1

Ádámné Szöllösi Cecília dhe  
Ádám István  
Bakó Józsefné dhe Bakó József  
Balázs Nikolett  
Balogh Anita dhe Süle Tamás  
Bánhidny András  
Becz Zoltán dhe Becz Mónika  
Bodnár Daniela  
Botka Zoltán dhe Botka Zoltánné  
Czeléné Gergely Zsófia  
Csepil Ildikó dhe Kovács Gábor  
Csuka György dhe  
Dr. Bagoly Ibolya  
Csürke Bálint Géza dhe Csürke Bálintné  
Dobsa Attila dhe  
Dobsáné Csáki Mónika  
Goran Dragojević dhe Irena Dragojević  
Éliás Tibor  
Dr. Farády Zoltán dhe Dr. Farády Zoltánné  
Farkas Gáborné dhe Farkas Gábor  
Fittler Diána  
Anton Gajdo dhe Olivia Gajdo  
Geczó Éva Krisztina  
Geczó László Zsoltné dhe Geczó László Zsolt  
Gecse Andrea  
Haim Józsefné dhe Haim József  
Hajcsik Tünde dhe Láng András  
Halomhegyi Vilmos dhe Halomhegyiné  
Molnár Anna  
Hofbauer Rita dhe Gavalovics Gábor  
Jancsik Melinda  
Jozó Zsolt dhe Molnár Judit  
Dr. Kálmánchey Albertné dhe  
Dr. Kálmánchey Albert  
Dr. Kardos Lajos dhe  
Dr. Kardosné Hosszú Erzsébet  
Kása István dhe Kása Istvánné  
Kemenczei Vince dhe  
Tamási Krisztina  
Keszlerné Ollós Mária dhe Keszler Árpád  
Kibédi Ádám dhe Ótos Emőke  
Klaj Ágnes  
Sonja Knezević dhe Nebojša Knezević  
Knisz Péter dhe Knisz Edit  
Kovács Gyuláné dhe Kovács Gyula  
Köves Márta  
Jadranka Kraljić-Pavletić dhe  
Nenad Pavletić  
Kulcsárné Tasnádi Ilona dhe Kulcsár Imre  
Lapicz Tibor dhe Lapiczné Lenkó Orsolya  
Dr. Predrag Lazarević dhe  
Dr. Biserka Lazarević  
Léránt Károly dhe Lérántné Tóth Edina  
Lukács László György  
Dr. Lukács Zoltán dhe  
Dr. Lukácsné Kiss Erzsébet  
Major István dhe  
Majorné Kovács Beatrix

Mayer Péter  
Mészáros Istvánné  
Branko Mihailović dhe  
Marija Mihailović  
Miklós Istvánné dhe Tasi Sándor  
Mirjana Mičić dhe Vilmoš Harmoš  
Mohácsi Viktória  
Molnárné Kalcsu Klára  
Mrakovics Szilárd dhe Csordás Emőke  
Mussó József dhe Mussóné Lupsa Erika  
Nagy Ádám dhe  
Nagyné Belényi Brigitta  
Nagy Gabriella dhe  
Márkus József  
Nagy Zoltán dhe  
Nagyné Czunas Ágnes  
Marija Nakić dhe Dušan Nakić  
Oltvölgyiné Zsidai Renáta  
Orosz Ilona dhe Dr. Gönczi Zsolt  
Orosz Lászlóné  
Papp Imre dhe Péterbenze Anikó  
Papp Tibor dhe Papp Tiborné  
Radics Tamás dhe Poreisz Éva  
Radóczy Tibor dhe Dr. Gurka Ilona  
Ramhab Zoltán dhe Ramhab Judit  
Ráth Gábor  
Rezván Pál dhe  
Rezvánné Kerek Judit  
Róth Zsolt dhe Róthné Gregin Tímea  
Rudics Róbert dhe  
Rudicsné Dr. Czinderics Ibolya  
Rusák József dhe Rusák Rozália  
Rusák Patrícia  
Dr. Steiner Renáta  
Tihomir Stilin dhe Maja Stilin  
Sulyok László dhe  
Sulyokné Kökény Tünde  
Szabados Zoltán dhe  
Szabadosné Mikus Emese  
Szabó Ildikó  
Szabó Péter  
Dr. Szabó Tamásné dhe  
Dr. Szabó Tamás  
Szeghy Mária  
Székely János dhe Juhász Dóra  
Szekér Marianna  
Széplaki Ferencné dhe Széplaki Ferenc  
Tanács Ferenc dhe Tanács Ferencné  
Tasnády Beáta dhe Vörös Zoltán  
Téglás Gizella  
Térmegi Lászlóné dhe  
Térmegi László  
Tordai Andre dhe  
Tordainé Szép Irma  
Tóth Tímea  
Dr. Dušanka Tumbas  
Túri Lajos dhe Dobó Zsuzsanna  
Miodrag Ugrenović dhe  
Olga Ugrenović  
Vareha Mikulas

Varga Zsuzsa  
Visnovszky Ramóna  
Viték László  
Zakar Ildikó  
Jožefa Zore

### Niveli 2

Botis Gizella dhe Botis Marius  
Császár Ibolya Tünde  
